



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 252/3 Prot.

Tiranë, më 05.02 2026

VENDIM

Nr. 19 , datë 29.01.2026

**“PËR KONFIRMIMIN E INSPEKTORIT ELENA PELUSHI, SI I KOMANDUAR NË
ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 29.01.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për konfirmimin e Inspektorit Elena Pelushi, si e komanduar në Zyrën e Inspektorit të
Lartë të Drejtësisë”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 252 prot., datë 22.01.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi Relatorin znj. Ledina Riza, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*më tej, Këshilli*), si një ndër organet qeverisë të sistemit të drejtësisë garanton statusin e magistratëve prokurorë, ku një aspekt të rëndësishëm zë karriera e tyre.
2. Me Shkresën nr. 2978 prot., datë 23.10.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (regjistruar me nr. 2602 prot., datë 23.10.2025), drejtuar Këshillit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (*në vijim, Inspektori*) ka informuar se, inspektorëve magistratë, respektivisht, prokurorëve Daniela Sulaj, Elena Pelushi, Lindita Ziguri dhe Julian Zonja, të komanduar pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u përfundon mandati i komandimit në datë 7.2.2026. Për rrjedhojë, Inspektori ka kërkuar nga Këshilli, konfirmimin e inspektorëve Daniela Sulaj, Elena Pelushi, Lindita Ziguri dhe Julian Zonja¹, si të komanduar pranë këtij institucioni edhe për një mandat tjetër 5-vjeçar.
3. Kjo kërkesë bazohet në rezultatet e punës së kryer nga ana e inspektorëve, profesionalizmit dhe integritetit si dhe nevojën për fuqizimin e mëtejshëm të veprimtarisë së këtij institucioni.
4. Kërkesa shoqërohet edhe nga dokumentet shoqëruese si vijon:
 - Vendim nr. 22/1, datë 31.07.2025, “Për vlerësimin etik dhe profesional të inspektorit magistrat të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë znj. Elena Pelushi për periudhën 08.02.2021-07.02.2025”, dhe Lidhja nr. 4, i Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit pranë zyrës së Inspektorit, sipas të cilit Inspektori Elena Pelushi është vlerësuar “*Shkëlqyeshëm*”;
 - Dhënie e pëlqimit për rekomandimin si inspektor në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. 2950, datë 21.10.2025, e Inspektorit Elena Pelushi;
5. Lidhur me sa më sipër, rezulton se, me Vendimin nr. 19, datë 27.01.2021 “Për komandimin e magistratit”, Këshilli ka vendosur komandimin e magistratit Elena Pelushi në pozicionin e Inspektorit pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
6. Periudha e komandimit sipas këtij vendimi është 5 vjet periudhë e cila ka filluar në datë 08.02.2021.
7. Kërkesa e Inspektorit për konfirmimin e inspektores Elena Pelushi, etj., si e komanduar pranë këtij institucioni edhe për një mandat tjetër 5-vjeçar bazohet në nenin 55, pikat 4 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

¹ Për prokurorët Daniela Sulaj dhe Elena Pelushi, pas procedurës së shortit si Relator u caktua znj. Ledina Riza

8. Përsa i takon bazës ligjore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit, në nenin 55, pikat 4 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Magjistrati mund të komandohet si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për një periudhë pesëvjeçare. Pas mbarimit të periudhës pesëvjeçare, Inspektori ka të drejtën e rikomandimit, në rast se është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional si inspektor.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një inspektori, mund t’i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim, përfshirë dokumentet e nevojshme, për konfirmimin e inspektorit si i komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këshilli konfirmon inspektorin nëse ai është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ka dhënë pëlqimin për konfirmimin. Kur kërkesa nuk është paraqitur në kohë, afati i pozicionit të komanduar si inspektor konsiderohet i mbaruar.”

9. Kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë drejtuar Këshillit për konfirmimin e inspektores Elena Pelushi, si e komanduar pranë këtij institucioni edhe për një mandat tjetër 5-vjeçar është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 55, pika 5, të ligjit të mësipërm. Sipas këtij neni, Këshilli konfirmon inspektorin nëse ai është vlerësuar të paktën “Shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ka dhënë pëlqimin për konfirmimin.
10. Bazuar në sa më sipër, konstatohet se kërkesa e Inspektorit për konfirmimin e inspektores Elena Pelushi, si e komanduar pranë këtij institucioni edhe për një mandat tjetër 5-vjeçar përmbush dy kriteret ligjore që parashikon dispozita e mësipërme, respektivisht, që inspektori të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe të kenë dhënë pëlqimin për konfirmimin.
11. Prokurori Elena Pelushi është emëruar prokuror në stazh me Dekretin nr. 3108, datë 01.10.2001, të Presidentit të Republikës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe ka vjetërsi në pozicionin e prokurorit rreth 23 vite.
12. Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozoi Këshillit konfirmimin e Inspektorit Elena Pelushi, si i komanduar në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, edhe për një mandat tjetër 5-vjeçar, duke filluar nga data 08.02.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenin 55, pikat 4 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, 166, 184, germa “d”, 189, pika 1, germa “a” dhe 211, pika

1, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin e Inspektorit Elena Pelushi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si i komanduar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Periudha e komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet dhe fillon nga data 08.02.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe prokurori Elena Pelushi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 29.01.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirëla Bogdani



ZV/KRYETAR
Erind Germenji



ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Zeqir Hoda


ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Erion Fejzulla

